

THIRRJE PËR APLIKIM

Përfaqësues rinor në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR)

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) është një mekanizëm institucional me funksionim të pavarur për bashkëpunim rinor ndërmjet pjesëmarrësve të Ballkanit Perëndimor, me një mision që synon:

- të mbështesë shkëmbimet rajonale të të rinjve, ndarjen mes tyre të ideve, si një bazë për perspektivat e bashkëpunimit në të ardhmen në rajonin tonë, bazuar në vlerat e bashkë-ekzistencës, tolerancës dhe respektit për të drejtat e njeriut dhe diversitetin, si dhe angazhimin për gjithëpërfshirjen dhe sigurinë;
- të rrisë bashkëpunimin rajonal ndërmjet të rinjve dhe institucioneve që u kushtohen të rinjve dhe të sigurojë zbatimin e programeve të përbashkëta për të rinjtë, me fokusin mbi parimet e qeverisjes demokratike, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimin dhe inovacionin;
- të koordinojë bashkëpunimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor.

Mandati i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) është të mbështesë projektet rinore që synojnë në, dhe kontribuojnë për:

- nxitjen e diversitetit dhe vlerave demokratike;
- rritjen e bashkëpunimit rajonal të qëndrueshëm mes të rinjve, dhe krijimin e marrëdhënieve të reja ndërmjet të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- inkurajimin e pajtimit dhe qasjeve konstruktive për kujtesën;
- të mësuarin ndërkulturor;
- rritjen e lëvizshmërisë rajonale;
- nxitjen e frymës së bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe tolerancës;
- pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive në proceset e vendimmarrjes për të rinjtë;
- përfshirjen sociale dhe nxitjen e punësimit të të rinjve.

Përfaqësuesi Rinor në Bordin Drejtues bashkëpunon në realizimin e detyrave dhe angazhimin e nevojshëm me synim përmbushjen e funksionit të kësaj strukture si më poshtë:

Bordi Drejtues është autoriteti më i lartë vendimmarrës i ZRBR-së dhe përbëhet nga dy përfaqësues, një përfaqësues qeveritar që është përgjegjës i drejtpërdrejtë për politikën rinore dhe një përfaqësues rinor. Bordi drejtues:

- përcakton rregullat e procedurës dhe rregulloret e tjera detyruese për funksionimin e ZRBR-së;
- përcakton një plan strategjik 3-vjeçar dhe plane operative vjetore të ZRBR-së;

- përcakton buxhetin vjetor të ZRBR-së dhe planin e saj financiar për periudhën 3-vjeçare në vijim;
- përcakton Raportin Vjetor të Programit;
- përcakton Raportin Financiar Vjetor;
- siguron mbështetje politike për planet strategjike, operative dhe financiare të ZRBR-së nga Palët Kontraktuese;

Në mbështetje të përmbushjes së misionit të ZRBR-së përfaqësuesi rinor:

- merr pjesë në mbledhjet e bordit drejtues;
- shqyrtojë dhe jep mendim mbi dokumentet strategjike dhe operacionale të ZRBR-së dhe çështje të tjera të ndërlidhura që adresohen në mbledhjet e bordit drejtues;
- të marrë pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga ZRBR ose Zyra Lokale e Shqipërisë sipas kërkesës dhe nevojës;

Referuar statutit të ZRBR-së, përfaqësuesi rinor duhet të jetë nga 18 deri 30 vjeç në fillim të mandatit dhe shërben për një mandat 3-vjeçar, pa mundësi për zgjatje mandati. Secila palë kontraktuese për zgjedh një përfaqësues rinor, duke përdorur mekanizmat e veta në një mënyrë transparente, gjithëpërfshirëse dhe demokratike, dhe në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, në përputhje me nenin 16, të Statutit të ZRBR-së.

Angazhimi në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) është pa pagesë.

Për më shumë informacion rreth ZRBR-së, referohuni në faqen zyrtare:

<https://www.rycowb.org/>

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 116/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, statutin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) dhe ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit Nr. 391, datë 07.05.2026 “Për fillimin e procedurave dhe ngritjen e komisionit të certifikimit për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për bashkëpunimin rinor (ZRBR)”, Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, ka miratuar metodologjinë dhe planin e veprimit për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor sipas afateve, kriterëve dhe dokumentacionit si vijon:

1. Përgatitja e dokumentacionit për thirrjen publike

- a) Përgatitja e thirrjes publike dhe dokumenteve mbështetëse për aplikimin e kandidatëve kryhet nga komisioni i certifikimit;
- b) Shpallja e thirrjes realizohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe publikohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe AKR në faqet elektronike zyrtare dhe median sociale;

c) Komisioni i certifikimit bashkëvepron me MTKS, AKR, ZRBR dhe organizatat jofitimprurëse rinore/për të rinjtë për zhvillimin e një fushate komunikimi në përputhje me fazat e përzgjedhjes.

2. Procedura për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar bordi të ZRBR

a) Kandidatët aplikojnë për pozicionin e shpallur pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë AKR-së, nga data 14 maj deri në datë 28 maj 2026, duke dërguar email me subjektin “**Aplikim për anëtar bordi ZRBR**” në adresën elektronike info@rinia.gov.al dhe ngarkuar dokumentacionin e kërkuar. **Dokumentacioni i ngarkuar në adresën elektronike përcillet edhe në formë shkresore pranë AKR-së, në adresën Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37, Tiranë, Shqipëri.**

Në qoftë se aplikimi nuk dorëzohet në formë elektronike dhe në formë fizike, nuk do të merren parasysh.

b) Komisioni i certifikimit verifikon dokumentacionin e dorëzuar dhe përgatit listën emërore të kandidatëve që kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe plotësojnë kriteret kualifikuese.

c) Kandidatët njoftohen për kualifikim ose jo në fazën e votimit, përmes adresës elektronike nëpërmjet së cilës kanë dërguar aplikimin. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimimit të vendimmarrjes së komisionit të certifikimit pranë Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në formë shkresore dhe përmes adresës elektronike info@mtks.gov.al, brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit elektronik.

d) Komisioni i certifikimit zhvillon një aktivitet informues me kandidatët e kualifikuar lidhur me veprimtarinë e ZRBR-së dhe pritshmëritë për detyrën.

e) Kandidatët e kualifikuar votohen nga organizatat jofitimprurëse rinore/për të rinjtë sipas parimit “një organizatë, një votë”, nga **data 2 qershor deri në datë 10 qershor 2026**, nëpërmjet dërgimit të emrit me subjekt “**Votim për kandidatin e ZRBR**” të kandidatit që mbështetet dhe ngarkuar dokumentacionin e kërkuar për organizatën, në adresën emailit info@rinia.gov.al.

f) Komisioni i certifikimit verifikon vlefshmërinë e çdo vote dhe përputhshmërinë e dokumentacionit shoqërues të dërguar me kriteret e thirrjes. Kur një organizatë voton në mënyrë të shumëfishtë, nuk ngarkon dokumentacionin shoqërues ose shkel afatin e votimit, vota e saj do të konsiderohet e pavlefshme.

g) Komisioni i certifikimit bën renditjen përfundimtare të kandidatëve bazuar në numrin e votave të vlefshme dhe njofton elektronikisht të gjithë kandidatët për rezultatin.

h) Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë vendimmarrjen e komisionit të certifikimit pranë Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në formë shkresore dhe përmes adresës elektronike info@mtks.gov.al, brenda dy ditëve nga marrja e njoftimit elektronik.

i) Ministri Turizmit, Kulturës dhe Sportit, pas përmbylljes së procesit të ankimimit, shpall fitues kandidatin që merr numrin më të lartë të votave të vlefshme dhe njofton zyrën qendrore të ZRBR-së.

j) Komisioni i certifikimit përgatit raportin përshkrues të procedurave të përzgjedhjes për Ministrin, në përmbyllje të procesit.

3. Kriteret që plotëson kandidati për aplikim si anëtar bordi i ZRBR

Të jetë shtetas shqiptar;

Të jetë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 30 vjeç, në datën 14 qershor 2026, që përkon me fillimin e mandatit;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit;

Të ketë njohuri minimale të gjuhës angleze, ekuivalente të nivelit B2;

Të ketë minimalisht 3 vite përvojë drejtimi në organizata jofitimprurëse që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbështetjen e rinisë ose në menaxhimin e projekteve dhe programeve me impakt tek të rinjtë;

Të mos jetë anëtar i partive politike, pjesë e organeve drejtuese apo i forumeve rinore të tyre dhe organizatave politike.

4. Kriteret që plotësojnë organizatat jofitimprurëse për pjesëmarrje në procesin e votimit të kandidatëve, janë si vijon:

a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin shqiptar për organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;

c) të kenë status “aktiv”.

5. Kandidati që aplikon për pozicionin e shpallur dorëzon dokumentacionin si vijon:

a) Fotokopje të letërnjoftimit;

b) Formular vetëdeklarimi për gjendjen gjyqësore, i nënshkruar;

c) Formular vetëdeklarimi për mosqenien anëtar i partive politike, pjesë e organeve drejtuese apo i forumeve rinore të tyre dhe organizatave politike, i nënshkruar;

d) Dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze, ekuivalente të nivelit B2;

e) Jetëshkrimi (CV) i kandidatit, ku të evidentohet qartësisht përvoja e angazhimit në fushën e rinisë;

f) Video prezantuese në gjuhën angleze (me kohëzgjatje deri në 2 minuta, me orientim vertikal-format reels, 1080 gjerësia në pixel dhe 1920 gjatësia në pixel), ku kandidati parashtron para komunitetit rinor përzgjedhës, profilin e tij, arsyet dhe shtysat e tij për aplikimin në pozicionin e shpallur dhe kontributin e pritshëm në mbështetje të misionit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor;

g) Autorizim i nënshkruar për publikimin e videos prezantuese dhe jetëshkrimit (CV) të kandidatit në faqet zyrtare dhe medias sociale të MTKS-së dhe AKR-së;

h) Vetëdeklarim për vërtetësinë e deklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar, i nënshkruar.

6. Organizata jofitimprurëse që merr pjesë në votim dorëzon dokumentacionin si vijon:

a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë (i skanuar);

b) Statuti i organizatës;

c) NIPT;

d) Vërtetim statusi aktiv/pasiv nga e-Albania, me datë jo më të hershme se 1 prill 2026.

Për çdo pyetje apo paqartësi, ju lutemi të na kontaktoni në adresën zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, info@rinia.gov.al